

**Mimoza HASANI PLLANA**

Universiteti i Sofjes „St. Kliment Ohridski”

Sofje, Bullgari

hasanimimoza@gmail.com

## **VEÇORITË E POEZISË SË KOSOVËS TË BOTUAR NË FUND TË SHEKULLIT XX - KONTEKSTI SOCIO-POLITIK**

**Mimoza HASANI PLLANA**

St. Kliment Ohridski University of Sofia

Sofia, Bulgaria

hasanimimoza@gmail.com

## **PECULIARITY KOSOVO POETRIES PUBLISHED AT THE END OF XX CENTURY - SOCIO POLITICAL CONTEXT**

The last decade of the XX century in Kosovo marked some poetic peculiarities with the following characteristic traits: female poetic works were published as well as poetry written in jails, further we witnessed publishing of poetic works of senior authors as well as a considerable number of poetic works of young authors presented for the first time to the reader.

**Keywords:** poetics, author, thematic, figure.

### **Hyrje**

Kërkimi ynë për poezinë shqipe të Kosovës të botuar në fund të shekullit XX shënon një përpjekje për të sjellë ide të reja dhe kuptim të ri për poezinë e një dekadë të rëndësishme për historinë letrare dhe socio-politike të Kosovës. Ndonëse, në vazhdimësi janë bërë studime, përsëri krahasuar me studimet e shumta mbi poezinë bashkëkohore të Kosovës, dekada e fundit e shekullit XX mbetet më e mangët. Ky boshllëk mund të jetë edhe për faktin se është një nga dekadat më produktive të shekullit dhe se shënon disa fenomene letrare që deri në fillim të viteve '90 ose ishin të fjetura ose të fshehura, siç është rasti me krijimtarinë e gjerë poetike të autoreve femra dhe me publikimin e poezisë së shkruar në mjedis burgu. Megjithatë, kjo dekadë shënon edhe vazhdimësinë e botimeve të autorëve të brezit të dëshmuar dhe

vlerësuar nga kritika letrare shqipe, por edhe botimet e reja të poetëve që u shfaqën para lexuesit në dhjetëvjetëshin e fundit të këtij shekulli. Puna jonë me veprat e përmendura realizohet duke interpretuar, sqaruar, analizuar dhe krahasur elemente të veçanta poetike me qëllim të krijimit të një perspektive epistemologjike për poezinë e një dekade. Kërkimet janë të bazuara në aspektin teorik dhe pragmatik të disa metodave të njohura letrare dhe të mbështetura në korniza ekzistuese teorike. Metodot kërkimore në të cilat është bazuar puna jonë i përkasin: metodës strukturale, metodës fenomenologjike dhe metodës së shkencës letrare krahasuese. Megjithatë, për faktin se studimi i letërsisë dallon nga shkencat tjera që përdorin metoda fikse studimore për të arritur një qëllim të caktuar shkencor dhe se letërsia nuk e ka këtë qëllim, puna jonë mbështetet edhe në përceptimet subjektive, bazuar në mundësitë që krijohen nga kritika impresioniste e cila mbështetet në shijen e lexuesit dhe përceptimin e tij subjektiv.

Shekulli XX në letërsinë shqipe është i njohur për prodhimin e të gjitha zhanreve letrare: prozës, dramës, kritikës, studimeve letrare dhe poezisë e cila është vazhdimësi e shekullit paraprak (Hamiti 2002a: 556-557), megjithëse poezia lirike është zhanri letrar më i eksploruar nga autorët shqiptar në përgjithësi, mund të jetë edhe zhanri më i pëlqyer dhe më i dashur. Kur ndalemi te letërsia e Kosovës (e ndërtuar nga të gjitha zhanret letrare), pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë ajo është kushtëzuar nga historia e saj (Krasniqi 2018: 99), çka do të thotë se procesi i krijimit të letërsisë është në relacion të ndërlidhur me procesin historik e politik dhe kështu siç u krijua edhe duhet të lexohet, pavarësisht se për kritikën e shek. XX rrethanat e kohës së shkrimit nuk janë relevante. Megjithatë, letërsia e Kosovës, rrjedhimisht poezia që i përket dekadës së fundit të shek. XX, kërkon të lexohet pa e përrjashtuar kontekstin social dhe politik, për faktin se ka ndikuar dukshëm në procesin e zhvillimit të saj. Në historinë letrare të Kosovës, vitet e fundshekullit të kaluar janë të shënuara si vitet e padrejtësive më të mëdha që janë bërë ndaj popullit shqiptarë që nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë (1912), periudhë e cila ndau territoret shqiptare në disa pjesë. Prandaj, duke bërë përpjekje për ta ruajtur kontekstin e kohës (pavarësisht se për kritikën e shek. XX rrethanat e kohës së shkrimit nuk janë relevante), do të sjellim veçori dhe fenomene poetike të poezisë së Kosovës që i përket fundit të shekullit XX.

### **Një proces poetik dhjetëvjeçar - një dekadë poetike**

Kur flasim për ndikimet e jashtme në poezi, konkretisht relacionit në mes të autorit, veprës dhe situatës, kemi parasysh rrezikun e vlerësimit të veprës, për faktin se duhet njohur kontekstin nga perspektiva të ndryshme dhe se duhet patur njohuri të thella të situatës që mund të kenë lënë gjurmë te poezia. Prandaj, në këtë punim do të paraqesim fenomenet dhe veçoritë e përgjithshme që në tërësi përfaqësojnë krijimtarinë e dekadës. Rrjedhimisht, jemi koshient se jashtë këtij shkrimi do të mbesë një pjesë e konsiderueshme e veprës poetike të kësaj dekade.

Dhjetëvjetëshi i fundit i shekullit XX, poezinë shqipe të Kosovës e karakterizon me fenomene te reja të lidhura me ndryshimet sociale e politike të kohës që

domosdoshmërisht lanë gjurmë në poezi. Prandaj, në këtë kërkim vështruam zhvillimin diakronik të poezisë sipas veçorive të sistemit poetik, strukturës dhe funksionit të saj, por edhe relacionit ontologjik ndërmjet poetit dhe lexuesit.

Fillimisht, kjo dekadë karakterizohet për ndryshimet dhe orientimet e reja që merr poezia shqipe e Kosovës, duke u nisur nga tematika që shpreh shqetësimet dhe preokupimet e shoqërisë kosovare në përgjithësi, të lidhura me identitetin kombëtar dhe krizën politike e sociale si shqetësime bazike të një dhjetëvjeçari. Po ashtu, është karakteristikë edhe përodrimi i gjuhës figurative në nivel të lartë, si përpjekje e poetëve për të shprehur mendimin përmes kuptimeve të dyta të fjalëve. Kjo mënyrë e re komunikimi vjen e imponuar nga rrethanat e krijuara politike, persekutuese për intelektualë, poet dhe qytetarë “kryengritës” në emër të së drejtës së barabartë për të gjithë. Pjesë e kauzës dhe temave për të drejtat dhe liritë e njeriut, u bënë edhe poetet e reja që heshturazi krijuan një fenomen të ri letrar që karakterizon dekadën, praninë e shtuar të gruas kosovare në nivelin autorial. Deri në fillim të viteve '90, gruaja shqiptare e Kosovës ishte personazh i çmuar në krijimtarinë poetike të poetëve, por rrallë mund ta gjeje si autore. Një tjetër fenomen poetik mund të konsiderohet poezia e migracionit, që shënon këtë dekadë përmes prirjeve të jashtëzakonshme të poetëve të rinjë emigrantë. Si fenomen, poezia e migracionit mund të lexohet edhe në kontekstin politik, psikologjik, dhe sociologjik me qëllim që të marrim kontribute të veçanta për të plotësuar perspektivën letrare. Fenomenet me bazë gjinore dhe ato të migracionit përveç se hapën perspektiva të reja, sollën vlera të reja tematike dhe semantike.

Botimet e poezive të shkruara në rrethana të jashtëzakonshme burgu, të njohura tani si poezi burgu, sjellin një kategori të re në rrafshin e përgjithshëm poetik. Ndonëse, edhe sot kjo kategori e poezisë dhe gjithë letërsia e shkruar në mjedis burgu, hynë në kuadër të letërsisë së pabotuar plotësisht për shkaqe të natyrës politike dhe sociale. Në rrafshin krahasimtar në mes shkrimeve dhe botimeve të letrave të burgut që autorët shqiptarë shkruan në Kosovë dhe Shqipëri, dilemat dhe situatat janë përafërsisht të njëjta. Akademik Shaban Sinani, në një studim kushtuar letërsisë së pabotuar, letërsinë e burgut e kategorizon si letërsi të dyshimit, për faktin se një pjesë e saj nuk është botuar, por edhe ajo që është botuar konsiderohet e dyshimtë për shkak të ndërhyrjeve që mund të jenë bërë dhe që vënë në pikëpyetje vullnetin e autorit (Sinani 2012: 8). Në fund, dy kategoritë më produktive mbesin ajo e brezit të autorëve të formuar dhe e poetëve të rinjë.

Në tërësi, korpusi poetik i Kosovës gjatë dhjetëvjeçarit të fundit të shek XX vlerësohet të jetë më voluminozi krahasuar me dekadat paraprake. Kjo përfshirje tejet e gjerë, këtë dekadë poetike e radhitë si më të pasurën sa i përket krijimeve të zhanrit të lirikës. Për studimin e përgjithshëm të veprave që sot shënojnë këtë dhjetëvjeçar, kërkohen njohuri të veçanta nga fusha sociale, politike dhe antropologjike. Prandaj, kemi zgjedhur që kërkimi ynë të trajtoj zhvillimin e përgjithshëm të procesit poetik, kategorive të mëdha të poezisë të cilat mund të quhen edhe fenomene poetike si dhe veçoritë tyre semantike.

*Poetët e brezit të dëshumar*, mund të veçohen si poetë që kërkimet e tyre letrare i përqendrojnë në trashëgiminë e vet shpirtërore dhe kulturore. Prirjet e tyre i ndërlidhin me të tashmen dhe me trashëgiminë, rrymat moderne të letërsisë dhe me letërsinë sociale në kërkim të autenticitetit (Hamiti 2002a: 555). Poetët e këtij brezi, botues të poezive edhe gjatë viteve '90, nuk iu ndanë temës nacionale, veçse në poezitë e kësaj kohe thelluan kuptimet figurative duke theksuar simbolin, ironinë dhe alegorinë, si figura që mbronin kup imet e para nga mbikëqyrja politike. Derisa vitet e '90 janë tregues i një situatë të trazuar për Kosovën dhe popullin e saj edhe përpjekjet orientoheshin drejt ruajtjes së identitetit shqiptar, mbijetesës sociale, ekonomike dhe kulturore të vendit. Jeta zhvillohej larg ritmeve normale të shumicës së vendeve ballkanike, si pasojë e ndryshimeve politike në ish-Jugosllavi nga të cilat Kosova pësoi thaujse më së shumti krahasuar me njësitë tjera që e përbënin atë. Krjiimi i veçorive të përbashkëta, ndodhë për faktin se gjatë këtij dhjetëvjeçari të gjithë poetët (përfaqësues) janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në situata nxitëse dhe konflikte, çka ndikon në ngacmimin e tyre emocional, si pasojë e shtypjes, dhunës dhe keqtrajtimit. Kjo situatë e rëndë krijon kriza emocionale dhe drama subjektive si pasojë e mohimit të lirisë në mënyrë arbitrare, mohimit të së drejtës për siguri personale, së drejtës për arsimim në gjuhën amëtare, mohimi i së drejtës për shprehje të lirë, për zhvillim të kulturës, pastaj mohimi i së drejtës për mbrojtje nga format e ndryshme të keqtrajtimit duke përdorur torturën, sjelljen poshtëruese dhe çnjerëzore ndaj një etnie që pretendonte të jetonte dinjitetshëm në atdheun e vet. Situata e rëndë socio-politike, prodhoi shqetësime me efekte në shumë procese përfshirë ato më vitalët: proceset arsimore, kulturore dhe letrare etj. Kur krizën e brendshme e shohim në kontekstin ballkanik, kujtojmë idetë e historianes bullgare Maria Todorova, të përfshirë në librin "*Ballkani imagjinar*", ku përveç se sjell rezultatet e hulumtimeve të rrugëtimit ballkanik, hulumtimin mbi ontologjinë e Ballkanit, sfidat politike, kulturore dhe historike që kanë kaluar popujt gjatë bashkëjetesës qindravjeçare, nxjerrë idenë e ndikimeve dhe rolin e fuqishëm që ka *tjetri* në konfliktet ballkanike (Todorova 1999: 163-171).

Në rrafshin estetik, autorët e këtij brezi, figuruan ngjarjet dhe emocionet shpirtërore kryesisht me simbole të lidhura për vendlindjen, fëmijërinë dhe mënyrën e jetësës së vendeve prej nga vinin. Në këtë formë figura e gurit, si një nga shprehjet më të shpeshta letrare të kësaj kohe transmeton kuptime me motive të shumta që vijnë nga emocionet e krijuara nga heshtja, qëndresa dhe durimi. Me kuptime të shumëfishta e gjejmë edhe figurën e malit. Varësisht nga konteksti, jo rrallë herë mali mund të interpretohet si figurë që shpreh jetëgjatësinë, fortësinë, pengesën. Azem Shkreli është nga poetët e njohur që me pasion përdor figurën e gurit dhe malit për të dhënë kuptime të ndryshme (Shkreli 2006: 115):

*Përsëri te ky gur i mirë  
Dhe ilirisht i lashtë rri unë rri fjala,*

Pastaj (Shkreli 2006: 103):

*Ju rroni sa malet  
Dhe mali shëndet t`u ketë.*

Figurat personale me bazë në vendlindje janë të shpeshta edhe në tri veprat e kësaj dekade të poetit Sabri Hamiti. Ndër të gjitha, pa dyshim se figura më e njohur mbet ajo e lules. *Lulëxheneti* dhe *lulëkuqja*, janë nga figurat simbole të fshatit prej na vjen poeti (Hamiti: 2002b):

*Pres si përherë errësim rreth veti  
Vdes në pranvere në lulëxheneti  
dhe  
Sot me njihni pi lëngun e jetës  
Lulja ka vdekur pi lëngun e saj  
ose  
Sot me njihni pi lëngun e jetës  
Lulja ka vdekur pi lëngun e saj.*

Te ky poet, figura e lules përveç se është një nga figurat më personale nëpërmjet së cilës poeti figuron gjendje emocionale, ajo kthehet në simbol të poezisë së Hamitit për të transmetuar kuptime të reja përtej atyre të zakonshme. Ky vlerësim vjen si rezultat i bazuar në teoritë e letërsisë që vlerësojnë se figura e përsëritur shpesh jep simbolin dhe se poezia e shkruar me gjuhë figurative gjeneron kuptime të figurshme që të zakonshmes i japin kuptim të jashtëzakonshëm nën dritën e reflektoar nga shpirti dhe bota e poetit (Rrahmani 2003: 99).

Përveç ndikimeve nga ambienti gjeografik, janë të pranishme edhe figurat me ndikime nga ambienti kulturor, si shenja autentike të vendlindjes karakteristike për ndërtimet e kështjellës, kullës e urës së gurit si pjesë e trashëgimisë kulturore (Shukriu 1990: 13):

*Shkëmb mbi shkëmb  
U ngrite  
Më parë se kohë e gurit...  
Më rrëfe kur takove ilirët  
Sa të qeshi zemërguri gaz....  
E romakët kur i pe  
Që t`i vodhën fushat...  
Dëfto, kalo e pagojë  
Për topat mbi supe  
E shpatat harkore  
Që t`i prisnin gjymtyrët*

*Për thepat  
Që i shkule nga gjiri  
Kur kuptove, ti urtësi e qytetit  
Se  
Perëndia nuk fliste shqip  
Dëfto për tregëtarët që i mbajte në prehër  
E të shitën në treg.....*

Vlerësimet se poetët, përveç figurave të vendlindjes, u frymëzuan edhe nga kodi etik shqiptar, si frymëzim qu ju krijojnë ndjenjën e të qenit përgjegjës për fatin kolektiv Kosovar (Aliu 2013: 9), veçojnë poetin Ali Podrimja, që në raste të caktuara si rezultat i refuzimit ndaj regjimit jugosllav dhe serb përmes fjalës poetike, është krahasuar me poetin me prejardhe hebreje *Osip Mandelstram*, që përmes vargut poetik shprehte kundërshti ndaj regjimit të Stalinit (Prietro 2010: 1-16). Poeti Podrimja, pohon se situatat personale dhe kolektive e shtynë të shkruaj poezi dhe se *ndjenjat shpirtërore, ngjarjet e mëdha dhe padrejtësitë ndaj popullit të tij e bënë të shkruaja poezi*” (Goldwyn & Hoxha 2012).

Poetët e njohur të këtij brezi që shënuan dekadën me botimet poetike janë: Azem Shkreli, *Nata e Papagajve* (1990), *Lirikë me shi* (1994), *Zogj dhe gurë* (1997), *Ali Podrimja, Zari* (1990), *Në bisht të sorrës* (1994), *Buzëqeshja në kafaz* (1994), *Ishulli Albania* (1998), Din Mehmeti; *Gjaku që këndon* (1993), *Prapë filimi* (1996), *Lumturia është mashtrim* (1999), Edi Shukriu; *Nënqielli* (1990), Sabri Hamiti; *Kaosmos, ABC dhe Melankolia*, Rrahman Dedaj; (1987), *Dreqi nuk plaket* (1991), *Kryqëzim hijesh* (1997).

*Vepa poetike e autoreve femra*, shënon një nga veçoritë themelore të dekadës, që sot mund të analizohet si një fenomen letrar që gruan e kthen në pozicionin krijues, në autore, nga pozicioni i personazhit siç është në veprën letrare të poetëve. Deri në fillim të viteve '90, të shekullit XX, letërsia shqipe në përgjithësi njih pak gra poete, aq më pak ajo e Kosovës. Edi Shukriu është nga poetet e para që botoi përmbledhje poezish dhe u vlerësua për arritjet estetike dhe për jetësimin *artistik të shpirtit poetik femëror* (Krasniqi 2016: f 275). Botimin e parë poetik, Shukriu e sjell në vitin 1972 me përmbledhjen “*Sonte zemra ime feston*”, ndërsa me botimin e dytë, “*Nënqielli*, shënon hapjen e dekadës së fundit të shek. XX. Kjo dekadë, si asnjë tjetër shënohet edhe me emrat e shumë poetëve të reja që pasuruan poezinë e Kosovës në rrafshin tematik bazuar në çështjet gjinore, shqetësimet për pozicionin e gruas në raport të pabarabartë me burrin në shoqëri, shqetësimet tjera nga përditshmëria e jetës kosovare, fragmente nga periudha të veçanta të historisë nacionale dhe tematika të lidhura me statusin social dhe kulturor të gruas shqiptare dhe europiane. Megjithatë, në poezinë e autoreve të Kosovës, në këtë shtrirje kohore, tematika nacionale me elemente nga përditshmëria e jetës kosovare dominon mbi tematikat me karakter universal. Çështjet gjinore dhe avansimi i gruas shqiptare në shoqëri në fillim të viteve '90 (shek XX.) fillon nëpërmjet poezisë dhe shnëdërrohet në kauzë që

vazhdon edhe sot. Poetja, Xheraldina Buçinca Vula, në poezinë e saj të përmbledhur te libri *“Me bisht syri”* (1995), i çaset problematikave shoqërore, në veçanti raporteve gjinore duke u pozicionuar në anën e femrës kosovare, në mbrojtje të drejtave të saj dhe duke shprehur gjithë revoltën poetike në adresë të botës mashkullore. Një qasje e përafërt tematike e karakterizon edhe poezinë e poetes Hida Halimi dhe deri diku poezinë e Fake Rexhës. Megjithëse Fakete Rexha, shkon përtej temave lokale, duke *poetuar dashurinë dhe vdekjen*, ajo hynë në kategorinë e poetëve që trajtojnë tematika me përmasa universale, derisa dashuria bashkë me vdekjen përherë kanë qenë dhe janë dy tema qendrore të letërsisë në nivel global. Poetet e reja që shënuan këtë dekadë me botimet e tyre nuk janë pak. Për këtë punim, ne morëm në shqyrtim veprat e autoreve: Fakete Rexha, *Mal me frymë* (1990) Naime Beqiraj, *Mbi Siparunt* (1990), Xheraldina Buçinca Vula, *A street cat* (1999). Po ashtu, për veprat poetike të botura gjatë viteve '90 janë të njohura edhe poetet: Donikë Gashi, Elvirë Durmishi, Ganimete Lekaj, Ganimete Podvorica, Hajrie Maksutaj, Hida Halimi, etj. Në rrafshin tematik, poetet e këtij brezi, ndonëse sollën vlera tematike me karakter universal, përsëri mbetën tek temat lokale, kryesisht influencuar nga konteksti social. Në një kohë të rëndë për shqiptarët e Kosovës, kur dhuna ndaj popullit shqiptarë bashkë me mohimin e të drejtave elementare për jetën, për kulturën e gjithë shqiptarë ushtrohej çdo ditë nga regjimi politik-ushtarak serb, ishte i pamundur qëndrimi indiferent i poetëve përballë një situatë të tillë e cila medoemos reflektohet në poezinë e tyre brenda disa tematikave. Poetet e dekadës, sot janë të njohura për lexuesin shqiptarë edhe për angazhimet dhe jetën aktive në funksion të promovimit dhe avancimit të vlerave gjinore në të gjitha nivelet e shoqërisë kosovare.

*Vepra poetike e diasporëskosovare*, nxjerr në pah tendencat e poetëve për ruajtjen e lidhjes kulturore letrare me atdheun. Poetët e emigruar nga Kosova, pavarësisht vendqëndrimit, gjatë kësaj dekade, u përpoqën që veprën e shkruar në shtetet europiane t'a publikonin në Kosovë dhe në vendin ku jetonin. Kemi prova se poezia e diasporës e publikuar gjatë këtij dhjetëvjeçari gëzon respektin e audiencës shqiptare e të huaj dhe vlerësohet lartë nga kritika. Vepra poetike e diasporës kosovare, është vazhdimësi e traditës shqiptare për krijimin letrar në diasporë. Shkrimtarët e mërguar, ndonëse të shkëputur fizikisht me kulturën e vendit, nuk ndaluan së krijuari në qendrat europiane ku zhvilluan krijimtarinë letrare duke ndjekur metodën e dygjuhësisë përmes së cilës poetët shqiptarë lanë gjurmë në letërsinë e vendit ku emigruan. Poeti kosovar Anton Marku, emigrant në shtetin austriak, të shkruarit e poezisë e vlerëson si një nga mënyrat nëpërmjet së cilës autorët shqiptarë sollën një frymë të re në letërsinë austriake, si për nga temat që trajtonin, stilin e shkrimit apo qasja ndaj fjalës së shkruar, si shenjzim estetik (Hasani Pllana 2019: 31-35). Në depërtimin e poezisë shqipe në kulturën europiane rol të rëndësishëm ka edhe procesi i përkthimit. Poezia e përkthyer është identifikuar për funksionin e saj në promovimin e poezisë shqipe në gadishullin ballkanik dhe në Europë, në tërësi. Në këtë hapësirë, poezia shqipe e Kosovës, gjeti lexuesin european sikur çdo veprë tjetër poetike e përkthyer në gjuhët europiane. Përkthimi i poezisë shqipe në gjuhët

europiane, në veçanti atyre të viteve '90 i ngjanë përpjekjeve për të krijuar paqe përmes artit letrar me qëllim të kapërcimit të ngjarjeve të errëta politike që shënonin kohën. Në këtë fushë, dy qendrat europiane, Sofja dhe Bukureshti, janë të njohura për numrin më të madh të përkthimeve të veprës së autorëve kosovarë në gjuhën bullgare dhe rumune. Përkthimet në gjuhën bullgare janë bërë të mundshme për motive të ndryshme: për t'i ndihmuar studentët që të zhvillojnë shkathtësitë e përkthimit, për të pasuruar bibliotekën e Universitetit "*Shën Klimenti i Ohrit*", ku në kuadër të studimeve ballkanike letërsia shqipe është lëndë e veçantë në kuadër të shkencës letrare krahasuese ballkanike që ofron ky universitet ku letërsia shqipe studiohet krahas gjuhëve dhe letërsive të vendeve ballkanike dhe europiane. Bazuar në një intervistë të realizuar me albanologun Rusana Bejleri, në gjuhën bullgare, deri tani janë përkthyer mbi 50 autorë shqiptarë përfshirë edhe poetët e viteve '90, të shek.XX. (Hasani Pllana 2019: 42). Në Rumani, janë motive tjera ato që e bënë të njohur letërsinë shqipe për lexuesin rumun. Ardian Kyçyku, profesor dhe përkthyes i njohur i letërsisë shqipe në Bukuresht, këtë qendër e vë mbi të gjitha qendrat tjera europiane, duke vlerësuar se asnjë hapësirë tjetër nuk ka qenë kaq e mbarë për kulturën dhe historinë shqiptare sa ajo rumune. Kyçyku kujton rilindasit shqiptarë që botuan së pari në Rumani, si Naimi, Lasgushi, Mitrushi, Asdreni e të tjerë, pra, gati një letërsi shqiptare më vete, një lloj ishulli, nga i cili del një kontinent, jo anasjelltas, thotë ai (Hasani Pllana 2019: 213). Poezia përfaqësuese e Kosovës, që i përket viteve '90-'99 në gjuhën bullgare është e përfaqësuar nëpërmjet disa poezive të veprës *Melankolia* (1999) të poetit Sabri Hamiti dhe disa poezi që i përkasin viteve 1998-1999 të poetit Sali Bashota, të publikuara më vonë në përmbledhjen poetike *Bukuri e Nëmur* (2006).

*Poezia e burgut*, si kategori e përgjithshme, në kontekstin letrar tashmë vlerësohet si një prurje që sjell novinitete letrare përmes shprehjeve, tematikave dhe figurave unike që pasurojnë tërësinë e koncepteve poetike pas Luftës së Dytë Botërore (Gjoka 2007: 221). Si fenomen letrar, por me kontekst të ndryshëm politik e letrar, *poezia e burgut* është e njohur në letërsinë shqipe si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Kjo kategori poezish, mund të konsiderohet si një platformë që mbahet fshehur për të sjell një provë të gjallë të torturës njerëzore në burgjet e tmerrshme të dy qendrave më të mëdha të letërsisë shqipe. Poezia e këtij lloji për dekada radhazi u ndalua të komunikoj me audiencën deri në dekadat e fundit të shek. XX. Studiuesi i njohur i letërsisë shqipe, Akademik Sabri Hamiti, dekadën e fundit të shekullit XX. e sheh si një përpjekje që në letërsinë shqipe të bëhet rigjetja dhe kthimi i autorëve të ndaluar që krijonin pa pasur asnjë mundësi komunikimi me lexuesin, duke tejkaluar mundimin e madh kur autorit i mungon komunikimi me publikun. Hamiti, vlerëson se shfaqja me vonesë e *autorëve të ndaluar* prish skemën e letërsisë shqipe tërësisht. Autorët e tillë sipas Hamitit janë: Camaj, Pipa, Terbeshina, Xhaferi dhe Zorba (Hamiti 2005: 228). Më specifikisht, në Kosovë, publikimi i parë i njohur i poezive të shkruara nga të burgosurit politikë i përket vitit 1991, kur shtëpia botuese *Zëri*, publikoi antologjinë e quajtur *Libri i Lirisë*. Prej asaj kohe, publikimet në këtë fushë nuk

pushuan, megjithatë procesi ende vlerësohet problematik për faktin se një pjesë e teksteve kanë mbetur në versionin e dorëshkrimit. Përveç mospublikimit, problematike për këtë kategori poetike mbetet edhe çështja e emërimit, kategorizimit, vlerësimit dhe përfshirjes së *letërsisë së burgut* në historinë e letërsisë shqipe (Kosoumi 2006: 1). Në rrafshin strukturor, si veçori të përbashkëta përmendim vargun e lirv, shumëllojshmërinë e strofës, mungesën e rimës dhe praninë e ritmit, figurativisht të arrirë përmes disa figurave të fjalëve dhe figurave të shqiptimit poetik.

### **Përfundime**

Dekada e fundit e shekullit XX. dukshëm bënë diferencën e diskursit poetik me dekadat paraprake, kur figurohej jeta personale e emocionale e poetëve, derisa në mbyllje të shekullit, diskursi poetik gjithnjë e më shumë figuron jetën kolektive, socio-politike të shoqërisë kosovare. Këto ndryshime janë të dukshme te autorët e brezit të formuar, të cilët veprat e para poetike botuan në fillim të viteve '60-'70 dhe në mënyrë sistematike vazhduan me krijimet letrare deri në fund të shekullit XX. Poetët e këtij brezi, në krijimtarinë poetike që shënon këtë dekadë, ruajtën formën tashmë të kultivuar, të lirë, në aspektin e vargut, strofës dhe rimes, por ndryshuan në aspektin tematik duke shkurar poezi me elemente politike e historike, duke e vënë vargun në funksion të interesave kombëtare dhe kundërshtimit të bindjeve politike të një regjimi monist, totalitar dhe autoritarist të konfederatës së ish Jugosllavisë, të shprehur në poezi përmes një gjuhe të dendur simbolike. Brezi i poetëve të rinjë, ndonëse sjell një gjuhë poetike rreth përjetimeve emocionale, nuk përjashton ndikimet që vijnë nga rrethanat e jashtme që shfaqen sikur reagime ndaj dhimbjes. Në rrafshin tematik, brezi i ri, hap rrugë për trajtimin e fenomeneve të reja, ndërsa në rrafshin stilistik, veçohet për dendësi figurative, duke e bërë poezinë vështirë të kuptueshme për faktin e ri-përdorimit të dendur të fjalëve të zakonshme me qëllim të shprehjes së kuptimeve të reja. Poetët emigrantë, gjatë kësaj dekade, përpiqeshin të ruanin lidhjen kulturore me vendlindjen duke publikuar veprën poetike në Kosovë si përpjekje për t'u identifikuar me vendin e origjinës në aspektin kulturor dhe atdhetar. Poezia e shkruar në burgje, përgjatë viteve paraprake, totalisht e panjohur për lexuesin e Kosovës, filloi të shihet dritën e botimit dhe të bëhet e njohur për lexuesin vetëm në fillim të viteve '90. Kjo vepër poetike, trajtohet si botim i viteve '90, duke theksuar se është produkt që i përket viteve '70-'80. Si vlerë të shtuar gjatë kësaj dekade e shohim interesimin e huaj për përkthimin e veprës poetike të dekadës në fjalë në gjuhë të ndryshme botërore. Kontribues të çmuar, në këtë proces konsiderohen miqtë e gjuhës dhe letërsisë shqipe që në vazhdimësi promovuan gjuhën dhe letërsinë shqipe para lexuesit botëror. Vepra poetike e autoreve të reja, shënohet si një fenomen që shfaqet me fillimin e dekadës. Deri pas Luftës së Dytë Botërore, femra kosovare ishte pjesë e letërsisë shqipe si personazh i çmuar i saj, ndërkaq në rolin krijues të poetës, në raste të rralla. Shikuar nga perspektiva gjinore, fillimi i viteve '90, ndryshon përgjithmonë statusin e saj në letërsinë shqipe të Kosovës. Që në publikimet e para, me ndjeshmërinë femërore, poetet e reja prekin tematika që përfshijnë çështjet gjinore, shqetësimet subjektive të gruas në raport

me të tjerët dhe satusin e saj në shoqëri duke krijuar një kauzë të re që në forma të ndryshme vazhdon edhe sot. Si vlerë të shtuar e shohim interesimin e albanologëve dhe përkthyesve europian për promovimin e poezisë shqipe të një dekade sensitive dhe sfiduese për poetët kosoovarë. Botimet poetike të poetëve është një fenomen i ri sepse figura e gruas si autore shfaqet shumë vonë në historinë e letërsisë shqiptare të botuar në Kosovë, përkundër faktit se “gruaja” ishte e lidhur fort me ngjarje të ndryshme historike dhe shoqërore në të kaluarën (Hasani Pllana: 2018). Në fund, poezia e dekadës së fundit të shekullit XX, sado që vlerësohet si poezi shpirtërore, mbetet e lidhur për ndryshimet politike të kohës.

### BIBLIOGRAPHY

- Aliu 2013:** Aliu, A. Vepra e Ali Podrimjes. ASHAK. 2013.
- Goldwyn & Hoxha 2012:** Goldwyn; Hoxha, R. Finally, Ali Podrimja Spoke. A Conversation. *World Literature Today*. May/Jun, 2012. Vol.86(3).
- Gjoka 2007:** Gjoka, B. Sistemi letrar piramidal. Faik Konica. Prishtinë. 2007.
- Hamiti 2002a:** Hamiti, S. Vepra letrare 9. Faik Konica. Prishtinë. 2002.
- Hamiti 2002b:** Hamiti, S. Vepra letrare 3. Faik Konica. Prishtinë. 2002.
- Hamiti 2005:** Hamiti, S. Tematologjia. ASHAK. Prishtinë. 2005.
- Hasani Pllana 2019:** Hasani Pllana, M. Shtegtimi i shqipes në Europë. OLYMP. Prishtinë. 2019.
- Hasani Pllana 2018:** Hasani Pllana, M. Thematic in the poetry compositions of young kosovar female poets at the end of XX century. *European Journal of Literature Studies*, [S.I.}, v, n.2, oct. 2018. <https://www.oapub.org/lit/index.php/EJLS/article/view/67>
- Krasniqi 2016:** Krasniqi, N.. Letërsia e Kosovës 1953-2000. AIKD. Prishtinë. 2016.
- Krasniqi 2018:** Krasniqi, N. Histori e letërsi. 99-AIKD. Prishtinë. 2018.
- Kosoumi 2006:** Kosumi, B. Letërsia e burgut. Botimet TOENA. Tiranë. 2006.
- Prieto 2010:** Prieto, J.M. Reading Mandelstam on Stalin. *The New York of Books*. 2010.
- Rrahmani 2003:** Rrahmani, Z. Leximi dhe shkrimi. Faik Konica. Prishtinë. 2003.
- Sinani 2012:** Sinani, Sh. Filologjia si shkencë dhe një letërsi e pabotuar, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Prishtinë. 2012.
- Shkreli 2006:** Shkreli, A. Nata e Pagajve. Rilindja. Prishtinë. 2006.
- Shukri 1990:** Shukriu, E. Nënqielli. Rilindja. Prishtinë. 1990.
- Todorova 1999:** Todorova, M. Is “the Other” a useful cross-cultural concept? Some thoughts on its implication to the Balkan region, Published by: Berghahn Books. // *Internationale Schulbuchforschung*, Vol. 21, No. 2 (1999).